



Planuar / Doretuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	01.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtoj. e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHTOK	5475/2023		1/10



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.863/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.863/2023 të datës 19.06.2023 të parashtruar nga ankuesi: _____ e adresë rruga _____, pa numër në Malishevë, kundër Vendimit me numër protokollit 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.863/2023 e datës 19.06.2023, e parashtruar nga ankuesi.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 08/27-649-2023 i datës 16.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 13.02.2023 ka publikuar Konkursin me numër KQZ-11/2023 për pozitën "Zyrtar i Komunale i Zgjedhjeve në Malishevë", në nivelin profesional-G 6/13.5, me afat të aplikimit nga data 13.02.2023 deri 28.02.2023. Në këtë konkurs

ka aplikuar dhe ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është përfshirë në listën e ngushtë së bashku me tetë (8) kandidatë të tjerë.

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 22.03.2023 Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit Nr.02-245-2023 të datës 08.03.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, ka hartuar raportin mbi vlerësimin e testeve me shkrim sipas të cilit del se nga nëntë (9) kandidatët vetëm tetë (8) ju kanë nënshtruar testit me shkrim, prej tyre katër (4) nga kandidatët përfshirë edhe ankuesin kanë kaluar fazën e testimit me shkrim, njëherazi duke propozuar që mbajtja e intervistës me gojë të realizohet më datën 24.03.2023. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit Njësia e Burimeve Njerëzore të SKQZ-së më datë 31.03.2023 ka njoftuar ankuesin së i njëjti ka arritur gjithsej 71.1 pikë të vlerësimit, rrjedhimisht sipas emailit të datës 31.03.2023 të Burimeve Njerëzore kandidatja E.M-P është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej 86.5 pikë duke u shpallur edhe si kandidatja e përzgjedhur për pozitën "Zyrtar i Komunale i Zgjedhjeve në Malishevë".

Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen, më datë 02.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa ky i fundit më Vendim me numër protokollit 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 31.03.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 16.06.2023 përmes emailit ankesa.kpmsnck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 19.06.2023 nën shenjën A.nr.863/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa kjo e fundit më datë 27.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 4823/2023 të datës 19.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për vazhdimin e afatit të konkursit; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 31.03.2023; Shpalljen e konkursit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vendit të lirë të punës për pozitën KQZ-11/2023; Përgjigje në kërkesë e datës 28.04.2023; Testin me shkrim i datës 209.03.2023; Vendimin me numër protokollit 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kërkesën për përgjigje në

ankesë e datës 26.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 27.06.2023; Vendimin me numër protokollit 02-245-2023 të datës 08.03.2023 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Raportin e datës 16.03.2023 të Kryesuesit të Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën KQZ-11/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevës; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 14.03.2023; Pikët e kandidatëve për vlerësim të pistës së ngushtë datë 14.03.2023; Njoftimin e datës 31.03.2023 për kandidatët për rezultatin përfundimtar; Njoftimin e datës 23.03.2023 për kandidatët për intervistë me gojë; Njoftimin e datës 17.03.2023 për kandidatët e listës së ngushtë dhe njoftimin për testin me shkrim; Testi me shkrim i kandidates E.M-P dhe ankuesit; Formularët e vlerësimeve individuale të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë); Formulari i Renditjes përfundimtare të kandidatëve; Raporti i Komisionit për vlerësimin e testeve me shkrim i datës 22.03.2023; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 30.03.2023; Kërkesë për aprovimin e rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës i datës 31.03.2023; Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 04.05.2023, 10.05.2023; Dërgim i Vendimit i datës 16.05.2023 përmes emailit për ankuesin; Konfirmim i pranimit të vendimit nga ankuesi datë 17.05.2023; Ankesën e datës 02.05.2023 nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për punësim të B.M, Deklaratën e datës 21.02.2023, Dokument identifikimi i B.M, Certifikatë mbi dënimet penale e datës 20.02.2023, Pasqyrën e llogarisë nga TRUSTI për periudhën 27.04.2007 deri 10.03.2023, Diplomën me Nr. 494/17, Certifikatën janar 2011, Certifikatën e vitit 2012 nga FINCA, Certifikatën nga SIGA UNIQA, Vërtetimin e datës 06.03.2018, Certifikatën e datës 15.09.2006, Certifikatën e datës 2805.2013, Letër rekomandim e datës 30.01.2018, Certifikatën 31.08.2000, Letër reference, Vërtetim për pranim të aplikacionit i datës 22.02.2023, Diplomën me Nr. 937/14; Kërkesë për punësim të E.M-P të datës 23.02.2023 në KQZ për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Deklaratën e E.M-P të datës 23.02.2023; Kopjen e Letërnjoftimit të E.M-P; Aplikacioni i kandidates E.M-P së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën mbi dënimet penale të E.M-P të datës 23.01.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Kontratën me numër protokollit 04-052-73 të datës 03.03.2021 në mes Ministrisë së Financave- Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe E.M; Marrëveshjen për shërbimet e veçanta të datës 26.10.2020 në mes KQZ-së dhe E-M; Vërtetimin e Sekretariatit të KQZ-së për E.M të datës 31.12.2017; Vërtetimin e Sekretariatit të KQZ-së për E.M të datës 26.09.2014; Vërtetimin e SH.M.P Qendra e Kompetencës " " për E.M të datës 21.05.2018; Kontratën e lidhur në mes " Bussines & Strateggies in Europe, S.A" dhe E.M; Letër rekomandimin e datës 28.12.2017 të Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa të KQZ-së për E.M; Letër rekomandimin e datës 14.02.2020 të Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme të KQZ-së për E.M; Vërtetimin e datës 13.12.2018 të N.T.P " Edorrita" për E.M; Referencën me numër protokollit 3009 të datës 29.08.2012 të Inspektoratit të Infrastrukturës Rrugore për E.M; Certifikatën e datës 15.12.2018 të lëshuar nga Akademia Profesionale Elita për E.M; Certifikatën e datës 23.06.2018 të lëshuar nga Akademia Profesionale Elita për E.M; Certifikatën e datës 21.06.2018 të lëshuar nga "IMB" për E.M; Certifikatën e datës 10-21.12.2018 të lëshuar nga "IMD" për E.M; Certifikatën e muajit Tetor 2013 të lëshuar nga Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve për E.M; Certifikatën e vitit 2017 të

lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për E.M; Certifikatë e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave për E.M; Certifikatë e lëshuar nga " BSC Kosovo" për E.M; Certifikatë me numër 552 të datës 06..01.2011 e lëshuar nga "ZAS Trade" për E.M; Certifikatë me numër 760 e lëshuar nga " ZAS Trade" për E.M; Marrëveshjen për shërbime të veçanta në mes KQZ-së dhe E.M të datës 11.01.2021; Vërtetimin për pranimin e aplikacionit me numër 02/2023 të datës 23.02.2023 në Divizionin e Personelit – SKQZ; Diplomën me numër 2423 të datës 05.07.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik për E.M; Diplomën me numër 424 të datës 18.11.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakultetit Ekonomik për E.M; Kërkesën për punësim të kandidatit D.G, CV-në, Referencën me Nr. 4654/18, Vërtetimin me Nr. protokolli 087/123, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 23.02.2023, Dokument identifikimi i D.G, Certifikatën e datës 21.06.2018, Certifikatën e vitit 2011, Certifikatën dhjetor 2020, Certifikatën mars 2007, Certifikatën maj 2022, Certifikatën 09.12.2015, Licencë e mësimdhënësit Nr. 1030300, Certifikatën maj 2013, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 24.02.2023, Diplomën me Nr. 2636; Kërkesën për punësim i kandidates B.K-R, Diplomën me Nr. 2729, Diplomën me Nr. 6149, Diplomën me Nr. 2918, Vërtetimin me Nr. Protokolli 35/2023 I datës 21.02.2023, Vërtetimi me Nr. Protokolli 117/2023 I datës 20.02.2023, Letër Referencës e datës 21.02.2023, Referencë e datës 20.02.2023, Dokument identifikimi i kandidates B.R, CV-në, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.02.2023, Certifikatën 2017, Certifikatën e datës 11.09.2015, Certifikatën e datës 29.11.2014, Certifikatën e datës 15.02.2010, Certifikatën e datës 03.07.2009, Vërtetim për pranimin e aplikacionit i datës 27.02.2023; Diplomën me Nr. 14-239-04/767, Vendimit me Nr. 116/08 I datës 12.12.2008, Kërkesën për punësim të kandidati L.Z, Dokument identifikimi i kandidatit L.Z, Pasqyre e notave 27.02.2023, Vërtetim I datës 27.02.2023, Vërtetim me Nr. 1/2023 I datës 23.02.2023, Pasqyra e llogarisë nga TRSUTI për periudhën 01.01.2011-20.02.2023, Letër reference Ref.nr.1/2023 e datës 23.02.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 23.02.2023, Vërtetim për pranim të aplikacionit I datës 27.02.2023; Kërkesën për punësim të ankuesit, Dokument identifikimi i ankuesit, Vendim me Nr. 216/3470 I datës 19.07.2021, Diplomën e me Nr. 15-P/09, Diplomën e datës 29.05.2003, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 27.02.2023, Vërtetimin e datës 22.03.2023, Vërtetimin e datës 30.11.2021, Vërtetim mbi përvojën e punës nga IVS, Vërtetimin e datës 27.02.2023, CV-në, Letër motivimi e ankuesit, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 19.09.2017, 15.01.2021, Letër referencës e datës 22.03.2018, 05.01.2020, Certifikatën e darës 27.05.2008, 02.07.2008, Letër referencës e datës 05.04.2021, 21.11.2017, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 10.09.2019, Vërtetimin 2021, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 28.02.2023; Kërkesë për punësim e kandidatit A.Z, Dokument identifikimi i kandidatit A.Z, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 27.02.2023, Letër motivimi, CV-në, Pasqyrë e llogarisë nga TRUSTI për periudhën 01.08.2002-23.02.2023, Vërtetimin për pranimin e aplikacionit i datës 28.02.2023, Certifikatën nga KQZ, Certifikatën Nr. Ev-243, Vërtetimin e datës 27.01.2021, Vërtetimin mbi përvojën e punës i datës 23.02.2023, Diplomën me Nr. 1376/0311; Kërkesën për punësim të kandidatit B.B, Vërtetimin e datës 23.02.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.02.2023, Diplomën me Nr. 9, Akt Emërimit e datës 27.01.2012, CV-në, Certifikatën 24.10.2016, nëntor 2015, qershor 2013, prill 2021, prill 2010, datës 31.03.2010, datës 12.03.2010, datës 03.07.2006, datës 03.07.2008, datës 11.04.2008, datës 08.10.2005, e datës 01.11.2001, datës 26.04.2001, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 31.01.2023, 06.01.2022,

19.01.2021, Dokument identifikimi i kandidatit B.B; Kërkesë për punësim e kandidatit A.K, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 28.02.2023, Dokument identifikimi i kandidat A.K, Kontratë e datës 01.06.2021, Diplomën me Nr. 2828, Certifikatën e datës 19.02.2020, Aktvendimin e datës 05.01.2010, Certifikatën e datës 30.08.2015, Certifikatën prill 2008, qershor 2013, shtator 2018, prill 2002, Kontratë Pune e datës 17.03.2008, 17.06.2009, Letër Referencë e datës 03.04.2019, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.12.2019, Letër Motivuese, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 27.01.2020, 24.01.2020, 16.07.2018, 24.01.2019, 02.08.2019, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë pa datë; Kërkesën për punësim të kandidatit A.P, Dokument identifikim i A.P, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 07.03.2023, Vërtetimin nga Qendra e Rinisë YOUTH CENTER e datës 06.09.2011, Certifikatën e datës 05.09.2008, Certifikatën e datës 21.07.2011, Pasqyrën e llogarisë nga TRUSTI për periudhën 01.08.2002 - 10.03.2023, Diplomën me Nr. 502/09; Kërkesë për punësim të M.M të datës 08.03.2023 në KQZ për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë; Kopjen e Letërnjoftimit të M.M; Vërtetimin e datës me numër protokoll 882/4 të 08.03.2023 të lëshuar nga Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"-Malishevë për M.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 07.03.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës për M.M; Letrën motivuese të datës 08.03.2023 të M.M; Referencën me numër protokoll 470/3 të datës 29.10.2018 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Letrën Rekomanduese të datës 31.10.2018 të Qendrës për Kompetencë në Malishevë për M.M; Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve me numër protokoll 477/3 të datës 29.10.2018 të Drejtorit të Qendrës së Kompetencës "Kujtim Krasniqi"-Malishevë për M.M; Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve të datës 29.10.2018 të Drejtorit të Qendrës së Kompetencës "Kujtim Krasniqi"-Malishevë për M.M; Vendimin me numër protokoll 342/2012 të datës 23.10.2012 të Qendrës së Kompetencës në Malishevë; Vërtetimin për punën praktike në shërbimin civil me numër protokoll 03/319 të datës 08.03.2012 të lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës për M.M; Certifikatën e datës 28.04.2017 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatën me numër 8559/003 të lëshuar nga MASHT dhe SBASHK për M.M; Certifikatën me numër 8248/002 të lëshuar nga MASHT dhe SBASHK për M.M; Certifikatën e muajit Nëntor dhe Dhjetor 2019 të lëshuar nga KDI; Certifikatën e datës 04.04.2019 të lëshuar nga KDI për M.M; Certifikatën e lëshuar nga ISEPS dhe Kolegji Universium për M.M; Certifikatën e muajit Qershor 2020 të lëshuar nga QAPA dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatën e datës 08.09.2014 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe M.M; Certifikatën e muajit Dhjetor 2009 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për M.M; Certifikatë me numër 1/17 të lëshuar nga "Lingua Link" për M.M; Certifikatën me numër 1/16 të lëshuar nga "Lingua Link" për M.M; Certifikatën me numër protokoll 175/09 të datës 07.07.2009 të lëshuar nga "The Neë York School" për M.M; Certifikatën 01M-0280-04 të datës 20.06.2004 të lëshuar nga FONDA KOS dhe Sektori i Kulturës për M.M; Mirënjohjen e datës 07.03.2012 të lëshuar nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë për M.M; Mirënjohjen e datës 03.12.2018 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Mirënjohjen e datës 21.06.2018 të lëshuar Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Mirënjohjen e datës 01.12.2017 të lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur për M.M; Pasqyra e llogarisë së Trustit për periudhën 01.08.2022-10.03.2023

të M.M; Vërtetimin për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit-SKQZ me numër 11/2023 të datës 08.03.2023 të M.M; Diplomën me numër 80 të datës 18.02.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik për M.M; Diplomën me numër 464 të datës 04.02.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik për M.M; Kërkesën për punësim të kandidatit G.K, Letër rekomandimin, CV-në, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.02.2023, Diplomën me Nr. 186, Certifikatën 23.03.2017, Dokument identifikimi i kandidatit G.K; Kërkesën për punësim e kandidates A.G, Dokument identifikimi për kandidaten A.G, Pasqyrë e llogarisë nga TRUSTI për periudhën 16.02.2016-02.03.2023, Marrëveshje për Praktike në punë e datës e datës 02.05.2019, Letër Rekomandimin e datës 23.02.2018, 26.02.2018, Vërtetimin e datës 17.09.2018 Diplomën me Nr. 5853, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.03.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit janë të **pabazuara, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokoll 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pretendon se ky vendim është i kundërligjshëm me të gjitha dispozitat në fuqi që rregullojnë këtë çështje, nuk janë shpall rezultatet për kandidatin e suksesshëm sipas renditjes; është përzgjedhur kandidatja që ka qenë e angazhuar me kontratë mbi vepër dhe përvoja e saj nuk ka të bëjë me përvojë në zgjedhje; Vazhdimi i konkursit për shtatë ditë është në kundërshtim me përbërjen e etnike të Komunës së Malishevës; Në pjesën e njohurive të përgjithshme të testit me shkrim janë parashtruar pyetje për vendin e punës dhe ka pasur poentim të pabazuar.

Referuar konkursit me numër KQZ-11/2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë", si kushte lidhur me kualifikimin, aftësitë dhe përvojën e punës janë përcaktuar: 1. Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkenca sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose statistikë; dhe 2. Së paku katër (4) vite përvojë pune.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Andaj, në lidhje me shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil, dhe monitorimin e rregullt vjetor, Këshilli ka kompetencë në raport me të gjithë shërbyesit civil pa përjashtim.

Për më tepër Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrton dhe vendos ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil edhe për Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mirëpo respekton pavarësinë funksionale dhe organizative duke respektuar aktet e tyre të brendshme lidhur me rregullimin e procedurave të rekrutimit, kështu që në mënyrë specifike Kolegji në trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative i'u

referua Ligjit Nr.03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës si dhe Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kolegji i Këshillit, sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se nuk janë shpall rezultatet për kandidatin e suksesshëm sipas renditjes, konstaton se ky pretendim është i pabazuar ngase, Zyra e Personelit e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për çdo hap të procedurës ka njoftuar kandidatët përmes emailit, respektivisht ankuesi për vlerësimin përfundimtar është njoftuar përmes emailit të datës 31.03.2023 dhe në të njëjtën kohë ju është dhënë mundësia për parashtrim të ankesës nëse ka qenë i pakënaqur me procedurë, konkretisht përmes këtij emaili është njoftuar edhe për numrin e pikëve të marra gjatë këtij procesi, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Zyra e Personelit e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka respektuar në përpikëri nenin 33 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor, i cili përcakton se: *"1. Personeli njofton me shkrim kandidatin/et e suksesshëm lidhur me rezultatin e tij dhe faktin se është përzgjedhur për emërim ne Sekretariat. 2. Personeli është përgjegjës për shpalljen e rezultateve te procedurës se rekrutimit ne tabelat për shpallje ne objektin e KQZ-se dhe ne veb faqen e KQZ-së. Njoftimi përmban emrat e kandidateve te suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës se përzgjedhjes. 3. Rezultatet publikohen brenda 7 ditëve pas përfundimit te procedurës se rekrutimit dhe vendimit për emërimin e kandidatit/eve te suksesshëm. 4. Te gjithë kandidatët e ftuar në përzgjedhjen dhe testimin përfundimtar informohen me shkrim"*, ngase të gjithë kandidatët janë njoftuar me shkrim për rezultatet.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se është përzgjedhur kandidatja që nuk ka përvojën e punës, Kolegji i Këshillit bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit ka gjetur së kandidatja e përzgjedhur E. M-P posedon Diplomën me Nr.2423 të datës 05.07.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përmes së cilës dëshkohet se më datë 20.10.2011 ka mbaruar studimet në Fakultetin Ekonomik në Departamentin për Menaxhment dhe Informatës duke marr titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë, kurse ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta sipas Referencës të datës 28.08.2012 ka ndjekur praktikën në Ministrinë e Infrastrukturës nga data 21.06.2012 deri më datë 20.07.2012, sipas Certifikatës të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave përmes të cilës dëshkohet se nga data 13.08.2012 deri më datë 31.08.2012 ka kryer praktikën ne Departamentin e Buxhetit Komunal, sipas Vërtetimit të datës 26.09.2014 ka punuar në SKQZ nga data 22.08.2013 deri më datë 31.12.2013 dhe nga data 12.05.2014 deri më datë 15.08.2014 në pozitën Zyrtare Financiare, sipas Vërtetimit të datës 31.12.2017 ka punuar SKQZ në pozitën Zyrtare e Financave nga data 13.05.2017 deri më datë 31.12.2017, sipas Vërtetimit me Nr. 99/3 të lëshuar nga SH.M.P Qendra e Kompetencës ' , " ka qenë në marrëdhënie punë nga data 09.02.2018 deri më datë 02.05.2018, sipas Letër rekomandimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përfunduar praktikën nga data 05.09.2019 deri më datë 15.02.2020, sipas Marrëveshjes për shërbime të Veçanta e njëjta nga data 26.10.2020 deri më datës 25.11.2020 ka punuar në KQZ në pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa, sipas Kontratës së Punës së datës 03.03.2021 të lidhur me Agjencinë e Statistikave të Kosovës e njëjta ka qenë në marrëdhënie punë nga data 03.03.2021 deri më datë 28.02.2023 në pozitën

Konsulent. Nisur nga këto dëshmi rezulton së kandidatja e përzgjedhur edhe pa përvojën e punës në N.P.T "EDORRITA", ka plotësuar kriterin e përvojës lidhur me pozitën e shpallur dhe rrjedhimisht Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 21 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se: *"Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional i dokumentuar, që konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit të kandidateve dhe dëshmitë e ofruara për shkollim dhe kualifikime dhe përvojën, vlerësimin e arsimimit dhe vlerësimin e trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse të përgjegjësi. 1.2 Përvoja e punës, që konsiston në eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale, varësisht nga pozita e klasifikuar e punës"* si dhe nenin 31 të kësaj rregullore më të cilin përshihet: *"Kushtet e kërkuara për emërim 1. Në Sekretariat emërohen kandidatet, të cilët kanë arritur numrin më të madh në total të pikëve në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë. 12 2. Pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë mbledhen dhe pjesëtohen për dy). 3. Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe intervistën me gojë) është vlerësuar me numrin më të madh të pikëve, jo më pakë se 60% të pikëve në total",* kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se vazhdimi i konkursit për shtatë ditë është në kundërshtim me përbërjen e etnike të Komunës së Malishevës, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të regjistrit të aplikacioneve të pranuar për pozitën *"Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malisheve"*, nuk ka pasur aplikacione në aspektin etnik, atëherë Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë vazhdimin e afatit të konkursit për shtatë (7) ditë të tjera për shkak të mos arritjes së balancuar të aplikacioneve në aspektin etnik, pasi që ky është kriteri i paraparë me dispozitat e nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili përcakton se: *"Nëse pas datës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është plotësuar kriteri etnik dhe gjinor, afati për pranimin e aplikacioneve zgjatet për shtatë (7) dite kalendarike dhe publikohet nga Personeli"*, rrjedhimisht sipas kësaj dispozite është obligim institucional që në rastet kur nuk ka aplikacione në aspektin etnik të vazhdohet afati për aplikim në mënyrë që t'iu ipet mundësi që të ketë aplikacione të balancuara në aspektin etnik, si rezultat i kësaj, Kolegji konstaton se Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka respektuar dispozitat ligjore të aplikueshme, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Sa i përket përgatitjes së testit me shkrim dhe mënyrës së tij, Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 02.05.2023 pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka pasur ndonjë pretendim ankimor konkret për mënyrën e përgatitjes së testit me shkrim, mirëpo Kolegji konstaton se testi me shkrim për këtë pozitë ka qenë i përgatitur në pajtim me nenin 27 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të të gjithë formularëve të vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, rezulton se Komisioni Përzgjedhës testin me shkrim dhe intervistën me gojë e ka vlerësuar në pajtim me nenin 28 respektivisht 30 të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kështu që pretendimi i ankuesit se ka pasur poentim të pabazuar, është pretendim i pa argumentuar dhe i pa qëndrueshëm.

Në kuptim të dispozitave e ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprime procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të rekrutimit sipas Konkursit Nr. KQZ-11/2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Malishevë" të shpallur nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe si rrjedhojë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale të cilat në esencë do ta bënin si të paligjshme këtë procedurë të pranimit, andaj mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimit më numër protokollit 08/27-649-2023 të datës 16.05.2023 ka vërtetuar drejt gjendjen faktike duke vepruar në pajtim me ligjin material përkatësisht Rregulloren Nr. 02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Udhëzimin Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe ka shqyrtuar në tersi pretendimet ankimore duke vepruar në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj pretendimi i ankuesit kundër këtij vendimi është i pabazuar.

Bazuar në atë që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.863/2023, datë 01/08/2023


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional


Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKQZ-së dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.